



BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin dyjavor / Nr.14

Nëntor 2004

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

I. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 5.11.2004

PROJEKTLIGJE

(Vendime për propozime projektligjesh)

1. Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës.

- Projektligji për gradat dhe karrierën është vazhdim i plotësim-it të paketës ligjore të Gardës së Republikës, pas miratimit të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës".

2. Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës së Eksport – Inport të Koresë, për projektin e elektrifikimit të zonave rurale.

3. Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kioto-s, të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara, për ndryshimet klimatike.

(Vijon në faqen 2)

Nga Punimet e Kuvendit

PËR PERIUDHËN 16-31 TETOR 2004

1. Projektligji "Për legalizimin e zonave informale", miratuar në seancë plenare më datë 28 tetor 2004

Projektligji është nismë e Këshillit të Ministrave dhe synon të realizojë integrimin e zonave informale në rrjetin urban kombëtar, përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve të këtyre zonave, si dhe legalizimin e ndërtimeve pa leje të ndodhura në "zonat informale". Në të jepet përkufizimi i "zonave informale", të cilat janë zona me karakter banimi, të zëna masivisht nga ndërtimet pa leje, me një sipërfaqe jo më të vogël se 10 mijë m², të ndërtuara pa u bazuar në studime urbanistike dhe duke mos respektuar kriteret e zhvillimit të infrastruktures, si dhe që nuk gëzojnë mbrojtje të veçantë nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

(Vijon në faqen 6)

Në këtë numër do të lexoni:

1. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave
faqe 1-5

2. Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore
faqe 1

4. Nga punimet e Kuvendit për periudhën 1-15 tetor 2004
faqe 1,6

5. Kalendari 2 javor i Kuvendit,
1-12 nëntor 2004
faqe 7-10

Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore

Kuvendi i Shqipërisë
www.parlament.al

Këshilli i Ministrave
www.keshilliministrave.al

Presidenca
www.president.al

Bashkia e Tiranës
www.tirana.gov.al

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
www.mash.gov.al

Ministria e Punëve të Jashtme
www.mfa.gov.al

Ministria e Shëndetësisë
www.moh.gov.al

Ministria e Rendit Publik
www.mpo.gov.al

Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
www.mpvd.gov.al

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
www.mtt.gov.al

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 1)

- Protokollin synon reduktim të detyruar ligjor të shkarkimeve të gazeve me efekt serre për vendet e zhvilluara dhe nxit vendet në zhvillim, ku përfshihet edhe vendi ynë, për të shtuar përpjekjet për transferimin e teknologjive të pastra për shkarkime të gazeve serrë, si edhe për përmirësimin e teknologjisë ekzistuese.

4. Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin ndryshues të Konventës Europiane për televizionin ndërkuftar”.

- Duke qenë pjesë përbërëse e Konventës protokollin rikonfirmim rëndësinë e parimit të lirisë së shprehjes dhe informimit. Kështu ai parashikon shkëmbimin e informacionit dhe të ideve, pavarësisht nga burimi i tyre, zhvillimin e kushteve lehtësuese ndërmjet palëve për transmetimin dhe ritransmetimin e programeve televizive, etj. Gjithashtu Protokollin ka për qëllim zhvillimin e mëtejshëm të parimeve të përcaktuara në rekomandimet e Këshillit të Europës, si për shembull, hartimin e strategjive për të luftuar duhanin, alkolin, për të drejtën për të dhënë lajm për veprimtari të rëndësishme, për përshkrimin e dhunës në mediat elektronike, etj.

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 5.11.2004

1. Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejës së përpunimit të nënprodukteve të naftës.

2. Për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre.

- Projektvendimi përbën një bazë të domosdoshme juridike për sigurimin e rezervës së sigurisë me naftë dhe nënprodukte të tyre duke dhënë mënyrën dhe

formën e përdorimit të tyre nga strukturat shtetërore, ku vendi përballet në situata krizash ose gjendje të jashtëzakonshme për furnizimin me këto produkte.

3. Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizimit të autorizuar, për kryerjen e vlerësimit të konformitetit.

4. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.198, datë 4.5.1993 “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave (të ndryshuar).

- Vendimi synon reformimin strukturor, administrativ dhe ekonomik – financiar të Entit Kombëtar të Banesave, si një domosdoshmëri për reflektimin e ndryshimeve në politikën e strehimit.

5. Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.405, datë 8.01.1996 “Për administrimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe rrjetit rural të Republikës së Shqipërisë”.

6. Për shpronësimin për interes publik të pronave të pasurive të paluajtëshme, që preken nga ndërtimi i autostradës Lushnjë – Fier”.

7. Për lejimin e Ministrisë së Drejtësisë të përdorë fonde buxhetore për blerjen e automjeteve, në përjashtim nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.490, datë 23.07.2004 “Për kufizimin e shpenzimeve buxhetore të vitit 2004”.

8. Për një shtesë fondi në buxhetin e shtetit të vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”.

9. Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksenburgut, për projektin e zhvillimit të bashkëpunimit “ALB/003: Asistencë teknike në mbështetje të

strategjisë shqiptare të furnizimit me ujë dhe shërbimeve sanitare”.

10. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të ish-Presidentit të Republikës Zotit Ramiz Alia.

11. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të deputetit Lekë Çukaj.

12. Për përdorimin e fondeve buxhetore për rehabilitimin e infrastrukturës në komunat Vig-Muel, Hajmel dhe Bashkinë e Vaut të Dejës, në Qarkun e Shkodrës dhe për dhënie ndihme familjeve të dëmtuara nga përmbytjet e lumit Gjadër.

13. Për lejimin e Bashkisë së Shkodrës të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë”, për realizimin e punimeve emergjente të sistemimit të objekteve mbrojtëse gjatë brigjeve të lumit Drin”.

14. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Avokaturën e Shtetit.

II. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 11.11.2004

PROJEKTLIGJE

(Vendime për propozime projektligjesh)

1. Për buxhetin e shtetit të vitit 2005.

2. Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat” (të ndryshuar).

- Me këtë projektligj propozohet, ndër të tjera, heqja e akcizës për rërat dhe reshpet bituminoze, rritja e akcizës së alkolit, rritja e akcizës së parfumeve në

(Vijon në faqen 3)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 2)

60%, ulja e akcizës për lëngjet e frutave dhe pijeve freskuese.

3. Për disa ndryshime në ligjin nr.9136, datë 11.12.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar). Ndryshimet që sjell ky projektligj janë:

- Organet tatimore duhet të mbledhin nga tatim paguesit vetëm shumat e kontributeve bruto (pa zbritur përfitimet),
- Ndryshimin e datës së pagesës nga 25 në 30.

4. Për një ndryshim në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar (të ndryshuar). Ndryshimi prek një sërë fushash ku ndër më kryesoret përmendim:

- Detyrimin për t’u regjistruar në TVSH të të gjithë tatimpaguesve që kanë statusin e personit juridik, pavarësisht nga vendimi i qarkullimit vjetor.

- Parashikimi i mënyrës së trajtimit tatimor të formave të reja të shitjes së mallrave me kontratë qeraje financiare.

- Vendosjen e TVSH-së për shitjen e parë të ndërtesave të reja të banimit si dhe për çdo shitje të ndërtesave të destinuara për qëllime të tjera nga 1 janar 2006.

- Unifikimin e shkallëve të apeimit të TVSH-së.

5. Për disa ndryshime në ligjin nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar). Ndryshimet në këtë projektligj janë:

- Përfshirjen në një të vetme të dy taksave të përdoruesve të mjeteve motorike.

- Ndarje më vete e dy mjeteve motorike të sektorit bujqësor dhe vendosja e një takse simbolike 2000 lekë.

- Ndryshimi i taksës së importimit të autovegurave të përdorura duke e lidhur me vitet e përdorimit, fuqinë motorike dhe një taksë fikse që ndryshon në rritje për makinat me naftë, etj.

6. Për disa ndryshime në ligjin nr.8952, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”.

- Ndryshimet konsistojnë në shfuqizimin e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtëshme mbas datës 31 dhjetor 2005, dhe që lidhet me vendosjen mbas kësaj date të TVSH-së mbi shitjen e ndërtesave, sipas ndryshimeve në ligjin për TVSH-në.

7. Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar). Shtesat dhe ndryshimet në projektligj kanë të bëjnë me:

- Rishikimin dhe përmirësimin e dispozitave që rregullojnë funksionimin e Policisë Tatimore.

- Ndryshimin e procedurave të regjistrimit të tatimpaguesve të taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe atyre të tatim fitimit të thjeshtëzuar mbi fitimin.

- Përmirësimin dhe lehtësimin e procedurave të kthimit të tatimeve të pagura më tepër, duke vendosur afate kohore.

- Uljen e normave të interesit në rastet kur tatimpaguesit nuk paguajnë në kohë detyrimet e tyre tatimore, etj.

8. Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (të ndryshuar).

Shtesat dhe ndryshimet që bëhen në këtë projektligj janë rreth 11, por ndër më kryesoret përmendim:

- Uljen e shkallës së tatim fitimit nga 25 në 23% për vitin 2005 dhe 20% në vitet e tjera.

- Reduktimi i numrit të shkallëve të tatimit mbi të ardhurat personale nga pagat nga 7 në 5 duke shtuar shkallën e re të tatimit prej 30% për pagat mbi 500.000 lekë.

- Zgjerimin e bazës së tatueshme të tatimit të fitimit, pavarësisht nga volumi i qarkullimit vjetor.

- Heqjen e detyrimit të tatimpaguesve të biznesit të vogël për t’u regjistruar çdo vit, me përjashtim të vitit 2005.

- Futjen e sistemit të detyrueshëm të deklarimit të të ardhurave personale pavarësisht nga burimi, etj.

9. Për disa ndryshime në ligjin nr.8981, datë 12.12.2002 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore” (të ndryshuar).

- Në projektligj pasqyrohen ndryshimet e niveleve tarifore të mallrave që janë pjesë e angazhimeve në OBT, angazhimin e nomenklaturës së kombinuar të mallrave, zbatimin e marrëveshjeve të tregëtisë së lirë dhe propozimet e biznesit, për reduktimin e tarifës së disa mallrave.

10. Për qiranë financiare.

- Projektligji trajton në detaje qeranë financiare, të drejtat dhe detyrimet e palëve në kontratë, si edhe rregullon marrëdhëniet që lindin në qiranë financiare të sendeve të luajtëshme dhe të paluajtëshme, duke krijuar hapësira të gjera veprimi, që çdo entitet vendas apo i huaj, publik apo privat të ndërmarrë biznesin e qerasë financiare në rolin e qiradhënësit dhe të qiramarrësit gjithashtu rëndësi i është kushtuar kushteve bazë mbi të

(Vijon në faqen 4)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 3)

cilat mbështetet marëdhënia e qirasë, si e drejta e pronësisë dhe mbajtja e rreziqeve, rastet e zgjidhjes së kontratës dhe pasojat e zgjidhjes së saj, etj.

11. Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, në emër të institucioneve të përkohëshme për vetqeverisje në Kosovë, për shmangien e tatiemeve të dyfishta, lidhur me tatiimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, për parandalimin e evazionit fiskal.

12. Për ratifikimin e marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar, për projektin e menaxhimit të burimeve ujore.

13. Për disa ndryshime në ligjin "Për taksën vendore mbi biznesin e vogël"

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 11.11.2004

1. Për miratimin në parim të marrëveshjes së projektit dhe të financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim, për "Kanalizimet Kavaja II", dhe të marrëveshjes së veçantë të këtij projekti.

2. Për miratimin në parim të marrëveshjes së Grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillim Bujqësor (IFAD), për programin për lehtësimin dhe futjen e fermerëve në tregjet e zonës ballkanike.

3. Për një ndryshim në vendimin nr.190, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë

17.11.1994, "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar" (të ndryshuar).

4. Për një ndryshim në vendimin nr.120, datë 4.3.2004, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit".

5. Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve të përdorë procedurën "Prokurimi i drejtëpërdrejtë", për rikonstrukcionin e urës së Rrjallit në Shkodër.

6. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, për shpërblimin e ekipit kombëtar të futbollit për fitoren në ndeshjen Shqipëri-Kazakistan.

7. Për shpalljen "Ansambël Historik" dhe "Zonë e stimuluar" të Pallatit të Brigadave dhe të parkut të tij.

8. Për miratimin e ndërtimit të linjës së interkonjeksionit Tiranë – Podgoricë, miratimin në parim të marrëveshjes së garancisë ndërmjet këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kreditanstalt Fur Wiederaufbau (KfW) Frankfurt am Main, për marrëveshjen e huasë dhe atë financiare, ndërmjet KESH. Sh.a. dhe KfW dhe miratimin në parim të Marrëveshjes së Arbitrazhit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe KfW.

9. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar në projek-

tin "Shkarkimi i ujrave të zeza" Kavaja II".

10. Për lejimin e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, që në emër të Ministrisë së Shëndetësisë të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për furnizimin me autoambulanca të sistemit shëndetësor publik.

III. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 19.11.2004

PROJEKTLIGJE

(Vendime për propozime projektligjesh)

1. Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen europiane në plotësim të "Konventës për trafikim rrugor, hapin për nënshkrim në Vjenë më 8 Nëntor 1968," bërë në Gjenevë më 1 Maj 1971.

- Marrëveshja përmban si element kryesor dy amendamente dhe aderimi në këtë marrëveshje është një plotësim tjetër i kuadrit ligjor në procesin e stabilizim – asocimit për Ministrinë e transportit dhe Telekomunikacionit. Gjithashtu marrëveshja parashikon marjen e masave për të përshtatur edhe legjislacionin tonë, më dispozitat e Konventës së Trafikut Rrugor.

2. Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Liqenit të Ohrit dhe të pellgut të tij ujëmbledhës.

- Marrëveshja e nënshkruar më 17.6.2004 ligjëron angazhimin e të dy vendeve për mbrojtjen e liqenit të Ohrit. Si rrjedhojë e interesimit të Shqipërisë dhe komunitetit të donatorëve për të

(Vijon në faqen 5)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 4)

vazhduar të njëjtat financime si në pjesën maqedone të liqenit të Ohrit, fitimi i statusit të "Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s për Vlerat Natyrore dhe Kulturore" edhe për pjesën shqiptare, e bëri të domosdoshme këtë marrëveshje.

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 19.11.2004

1. Për miratimin e strategjisë Kombëtare të Migracionit.

2. Për krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.478, datë 16.07.2004 "Për pranimet në universitetet dhe shkollat e larta, në sistemin me shkëputje nga puna, si dhe për tarifën e shkollimit për vitin akademik 2004-2005".

4. Për miratimin në parim të marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mediocreditocentrale, S.p.A, për financimin e programit "Rehabilitimi dhe pajisja e 5 poliklinikave".

5. Për miratimin në parim të antarësimit të Republikës së Shqipërisë në traktatin "Qiejt e Hapur".

6. Për miratimin në parim të marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane "Për programin vjetor kombëtar të veprimit CARDS-2004.

7. Për miratimin në parim të Marrëveshjes Kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European, për parime

e përgjithëshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet komunitare.

8. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme për pagesën e shërbimeve ligjore për çështjen e pronësisë së 10 apartamenteve në Romë në adresën "Via Eritrea, nr 34".

9. Për shpërblimin e anëtarëve të Komisionit mbikqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

10. Për lejimin e Ministrisë së Rendit Publik të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për blerje benzine super, pa plumb.

11. Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për sistemim-asfaltimin e rrugës së kishës në Rubik.

12. Për shtyrjen e afatit të procedurave të prokurimit nga Ministria e Mjedisit, për objektin "Punime shtesë në Porto-Romano, Durrës".

13. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën Karbunarë.

14. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën e Ujmishit.

15. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën Xhafrataj.

16. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën Funarë.

17. Për kalimin në përgjegjësi administrimi të prefektit të qarkut të Tiranës, së një magazine e cila është në përdorim të Drejtorisë së Përgjithëshme të

rezervave të Shtetit, në Agjensinë Kavajë.

18. Për lejimin e Sh.a. Ujësjellësit Peqin, për përdorimin e procedurës "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për shmangien e rrëshqitjes së depos së ujit të pijshëm të qytetit të Peqinit.

19. Për miratimin në parim të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për fuqizimin e kapaciteteve institucionale, për reformën në marrëdhëniet ndërqeveritare fiskale.

20. Për miratimin në parim të marrëveshjes specifike ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Suedisë, për asistencë teknike të furnizimit të sistemit të menaxhimit dhe të mirëmbajtjes së shërbimeve shëndetësore shqiptare, 15 tetor 2004-15 prill 2007.

21. Për dhënie pensioni të posaçëm shtetëror zotit Minella Shallo.

22. Për dhënie pensioni të posaçëm shtetëror zotit Petrit Velaj.

23. Për dhënie pensioni të posaçëm shtetëror zotit Robert Papajani.

24. Për dhënie pensioni të posaçëm shtetëror zotit Jorgji Adhami.

25. Për dhënie pensioni të posaçëm shtetëror zotit Theodor Janku.

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 16-31 TETOR 2004

(Vijon nga faqja 1)

Për të realizuar qëllimin e projektligjit, në të parashikohet zgjidhja e disa problemeve komplekse, që kanë të bëjnë kryesisht me pronësinë e tokës, mbi të cilën janë ndërtuar banesa pa leje, si dhe hartimin e planeve të urbanizimit të zonave informale.

Gjatë diskutimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seance plenare përfaqësuesit e Partisë Republikane e kundërshtuan atë në parim, me argumentin që ai nuk i jep zgjidhje disa problemeve kryesore si:

- Ai nuk zgjidh të drejtën e pronarëve legjitimë, duke e kaluar të drejtën e pronësisë nga një pronar në tjetrin me ndërhyrjen e shtetit në mënyrë arbitrare;

- Shteti i jep vetes të drejtën e pronarit, duke marrë në mënyrë arbitrare titullin e pronësisë për pasuritë e paluajtshme që nuk janë rregjistruar si pronë private;

- Projektligji bie ndesh me ligjin nr.7980, date 27.7.1996 "Për shitblerjen e trojeve", i cili përcakton rastet e kalimit të trojeve të lira nga pronë shtetërore në pronë private, në të cilin nuk përmendet si rast ndërtimi i banesave pa leje.

- Projektligji nuk përcakton mekanizmat ligjorë dhe ekzekutivë për të frenuar zhvendosje të tjera të popullsisë drejt qendrave më të mëdha dhe nuk i jep zgjidhje çlirimit të kapitaleve të fjetura dhe të investuara në këto zona. Ai nuk parashikon një reformë territoriale dhe një plan urbanizimi, nuk parashikon koston e urbanizimit dhe të kompensimit të pronarëve dhe, duke qenë se nuk përban ndonjë faturë financiare, mbetet deklarativ e i pazbatueshëm.

Ata ishin të mendimit se toka u duhet kthyer pronarëve legjitimë, të cilët janë në gjendje ta administrojnë atë më mirë, ndërsa shteti duhet të mbajë barrën e hartimit të politikave urbane, të kryerjes e zbatimit të studimeve urbane. Për të gjitha arësytet e mësipërme, ata e kundërshtuan projektligjin në parim.

Projektligji u kundërshtua edhe nga deputetët e Partisë Demokratike, të cilët paraqitën amendamentet përkatëse.

Përfaqësuesit e Qeverisë spjeguan domosdoshmërinë e projektligjit, duke hedhur poshtë kundërshtimet e deputetëve opozitarë për çështjet që ata ngritën.

Gjatë diskutimit të projektligjit nen për nen, një nga nenet më të diskutuara ka qenë neni 10 i projektligjit, i cili bën fjalë për zgjidhjen e pronësisë mbi sipërfaqen e zënë nga ndërtimet pa leje. Konkretisht, debati u përqëndrua në vlerësimin e sipërfaqes së zënë nga ndërtimet e banesave pa leje. Projektligji parashikon dy raste. Rasti i parë është kur sipërfaqja e zënë me ndërtim është pronë jopublike e paluajtshme e shtetit, ndërsa rasti i dytë është kur sipërfaqja e zënë me ndërtim është pronë private. Në rastin e parë, projektligji parashikon që shteti ua shet ndërtuesve të banesave sipërfaqen e tokës së zënë prej tyre në bazë

të ligjit nr.8561, date 22.12.1999 "Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik".

Në rastin e dytë projektligji parashikon dy nënraste. Nënrasti i parë është kur arrihet një marrëveshje dhe lidhet një kontratë midis pronarit të tokës dhe ndërtuesit të banesës pa leje. Në këtë rast vlera e sipërfaqes së tokës të zënë me ndërtim do t'u kthehet pronarëve të tokës nga ndërtuesit e banesës në përputhje me këtë kontratë. Në rastin që kjo marrëveshje nuk arrihet, projektligji parashikon që pronari i tokës do të kompensohet nga shteti në bazë të statusit që ka patur sipërfaqja e zënë me ndërtim në çastin e fitimit të pronësisë, pra me vlerën e tokës bujqësore, ndërsa ndërtuesi i banesës do t'i paguajë shtetit vlerën e sipërfaqes së zënë me ndërtim në bazë të statusit të ri të saj, pra me vlerën e truallit.

Gjatë diskutimit deputetët ngritën shqetësimin që parashikimi nga projektligji i kompensimit të pronarëve të truallit bie ndesh me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" dhe duhet të përputhet me të. Kuvendi e miratoi këtë propozim, duke vendosur që pronarët e truallit të kompensohen nga shteti me vlerën e tij në çastin e kryerjes së legalizimit.

Lidhur me pagesën nga ndërtuesit e banesave të truallit të zënë me ndërtim, Kuvendi diskutoi disa variante. Amendamenti i paraqitur nga deputetët e opozitës propozonte që vlera që duhet të paguajnë ndërtuesit e banesës duhet të përputhet me nenin 8, pika 3 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", që nënkupton vlerën e truallit në vitin 1992, shumëzuar me indeksin e çmimeve. Ky propozim nuk u pranua nga maxhoranca e Kuvendit, i cili vendosi që ndërtuesit e banesave të paguajnë vlerën e truallit në bazë të vlerës së tregut në çastin e kryerjes së legalizimit.

Një propozim tjetër që u paraqit në amendamentet e opozitës ka të bëjë me shtimin e një neni, i cili të marrë në konsideratë asistimin e ndërtuesve të banesave me kredi nga Qeveria, e cila të paguajë një pjesë të interesave për familjet që nuk kanë para për të paguar tokën. Githashtu, ata propozuan që për kalimin e pronësisë së truallit tek ndërtuesit e banesave të jepet mundësia e disa varianteve si e pagesës së menjëhershme, e pagesës me këste ose e marrjes së truallit me qira për një periudhë të caktuar. Këto propozime nuk u pranuan nga shumica e deputetëve, duke e lënë në kompetencë të Këshillit të Ministrave që të gjykojë për këtë çështje, e cila kushtëzohet nga mundësitë financiare të Buxhetit të Shtetit.

Kuvendi diskutoi dhe miratoi edhe disa ndryshime të tjera në tekstin e projektligjit, më qëllim përmirësimin e përmbajtjes së tij.

Në përfundim, Kuvendi e miratoi projektligjin me shumicë votash.

KALENDAR I

2 JAVOR (16-25 NËNTOR 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

**E Martë, datë 16.11.2004,
ora 17.00**

-Seancë Plenare

1. Miratimi i Kalendarit 2 javor të punimeve të Kuvendit.
2. Miratimi i Programit të Punës “Për shqyrtimin dhe miratimin e p/ligjit “Për Buxhetin e Shtetit të Vitit 2005” dhe Paketës Fiskale”.
3. Interpelancë me Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, kërkuar nga deputetja Marjeta Zaçe.
4. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Muhamet Ukperaj nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale.

E mërkurë, datë 17.11.2004
Punë në Komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi; për vendosjen e linjës Ndërkombëtare Liqenore për udhëtarë, Shkodër – Virpazar”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Industrisë

2. P/ligji “Për ratifikimin e Konventës nr.97 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Për Migracionin për punësim”, të rishikuar”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

**-Komisioni i Punës dhe Ç/
Sociale**

3. P/ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes Ushtarake grant, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Mbrojtjes

**-Komisioni i Ekonomisë
dhe Financave**

4. P/ligji “Për privatizimin e banesave të ndërtuara dhe të blera me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore dhe të objekteve të tyre të kthyera në banesa”. (paraqitur nga deputetët Y.Bufi dhe A.Çaçi).

**-Komisioni i Ligjeve (e ka
shqyrtuar)**

**-Komisioni i Ekonomisë
dhe Financave**

-Komisioni i Industrisë.

5. P/ligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

-Komisioni i Ligjeve

**-Komisioni i Punës dhe Ç/
Sociale (e ka shqyrtuar)**

**-Komisioni i Ekonomisë
dhe Financave**

6. P/ligji “Për barnat dhe shërbimet farmaceutike”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Shëndetësisë

**-Komisioni i Ekonomisë
dhe Financave**

7. P/ligji “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

-Komisioni i Ligjeve

**-Komisioni i Punës dhe Ç/
Sociale**

**-Komisioni i Ekonomisë
dhe Financave**

8. Shqyrtimi i propozimit të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë për të zgjedhur anëtarë të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë z.Limoz Malaj.

-Komisioni i Ligjeve

9. Shqyrtimi i P/Rregullores të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

**-Komisioni i Rregullores
dhe Mandateve**

-Komisioni i Ligjeve

-Komisionet e tjera

10. P/Ligji “Për miratimin e strategjisë së sigurisë në Republikën e Shqipërisë”.

**- Komisioni i Ligjeve (e ka
shqyrtuar)**

-Komisioni i Mbrojtjes

**-Komisioni i Jashtëm (e
ka shqyrtuar)**

-Komisioni i Rendit

11. P/Vendim “Për komisionin hetimor parlamentar “Për Prokurimet Publike të Kryeministrit dhe Ministrive”.

–Komisioni i Ligjeve

(Vijon në faqen 8)

KALENDAR I

2 JAVOR (16-25 NËNTOR 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 7)

12. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" (paraqitur nga Qeveria dhe varjanti i përpunuar nga Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit (e ka shqyrtuar)

13. P/Ligje të Paktës Fiskale:

1. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 8982, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave vendore".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisionet e tjera

2. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisionet e tjera

3. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8978, datë 12.12.2002 "Për taksën vendore mbi biznesin e vogël".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisionet e tjera

4. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për Akcizat" të ndryshuar".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisionet e tjera

5. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale

-Komisionet e tjera

6. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8981, datë 12.12.2002 "Për miratimin e niveleve të Tarifës Doganore", të ndryshuar".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisionet e tjera

7. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisionet e tjera

8. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisionet e tjera

9. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisionet e tjera

10. P/Ligji "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005".

-Komisionet e përhershme

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

E Enjte, datë 18.11.2004, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. P/Ligji "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për asistencë të ndërsjelltë

(Vijon në faqen 9)

KALENDAR I

2 JAVOR (16-25 NËNTOR 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 8)

- Administrative në çështjet doganore”.
2. P/Ligji “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë.
 3. P/Ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8615, datë 1.6.2000 “Për Urdhërin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”.
 4. P/Vendim “Për Komisionin Hetimor Parlamentar për Prokurimet Publike të Kryeministrit dhe Ministrive”.
 5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë për të zgjedhur anëtar të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë, zotin Limos Malaj.

* * *

**E Hënë, datë 22.11.2004,
ora 17.00**

-Seancë Plenare

1. Interpelancë me Kryeministrin, kërkuar nga deputeti Sokol Olldashi.
2. P/vendim “Për hetimin e akuzave publike të bëra për kryeministrin për përfshirjen e tij në trafik armësh, aksidentin rrugor me pasojë vdekjen e një shtetasi dhe veprime në fyerje të zisë kombëtare”.

E Martë, datë 23.11.2004

**E Mërkurë, datë
24.11.2004**

Punë në Komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr.9040, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (paraqitur nga një grup deputetësh, si dhe p/ligji i paraqitur nga deputeti N.Alibali).

-Komisioni i Ligjeve

**-Komisioni i Ekonomisë
dhe Financës**

2. P/Ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Polonisë, për mbrojtjen e përbashkët të informacionit të klasifikuar”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Rendit

3. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8732, datë 24.1.2001 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”.

-Komisioni i Ligjeve

**-Komisioni i Bujqësisë dhe
Ushqimit (e ka
shqyrtuar)**

4. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8685, datë 9.11.2000 “Për trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”. (paraqitur nga një grup deputetësh).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Industrisë

**-Komisioni i Punës dhe Ç/
Sociale**

**-Komisioni i Ekonomisë
dhe Financave**

5. P/Ligji “Për një trajtim të veçantë financiar të detarëve që kanë punuar në nëndetëse në pension”. (paraqitur nga një grup deputetësh).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Mbrojtjes

**-Komisioni i Punës dhe Ç/
Sociale**

**-Komisioni i Ekonomisë
dhe Financave**

6. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Industrisë

7. P/Ligji “Mbi Dhomën e Mjekëve Veterinarë dhe profesionin e mjekut veterinar”

(Vijon në faqen 10)

Kalendari dyjavor i punimeve të Kuvendit

(Vijon nga faqja 9)

(paraqitur nga deputeti N.Alibali).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit

8. P/ligji “Për kontrollin e figurës së personit zyrtar të zgjedhur apo të emëruar në organe të rëndësishme të shtetit”. (paraqitur nga deputetët N.Ndoka, A.Çako, I.Berzani).

-Komisioni i Ligjeve

9. P/ligji “Për konfliktin e interesave” (paraqitur nga grup deputetësh).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

10. P/Ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9268, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” (paraqitur nga një grup deputetësh).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

11. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve” (paraqitur nga një grup deputetësh).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

E Enjte, datë 25.11.2004, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. P/ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi; për vendosjen e linjës Ndërkombëtare Liqenore për udhëtarë, Shkodër – Virpazar”.

2. P/ligji “Për ratifikimin e Konventës nr.97 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Për Migracionin për punësim”, të rishikuar”.

3. P/ligji “Për privatizimin e banesave të ndërtuara dhe të blera me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore dhe të objekteve të tyre të kthyer në banesa”. (paraqitur nga deputetët Y.Bufi dhe A.Çaçi).

4. P/ligji “Për miratimin e strategjisë së sigurisë në Republikën e Shqipërisë”.

5. P/Ligji “Për barnat dhe shërbimet farmaceutike”.

6. P/Ligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i P/Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Njoftim

Të nderuar zonja e zotërinj,
Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”. Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare. Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, informacionin mbi dokumentat zyrtare.

Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar ti krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e informacionit të kërkuar. Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.

Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga autoriteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.

Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare “QSP” në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;

“Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare” do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat. Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30

Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP.”

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator

Qendra e Studimeve Parlamentare/Centre for Parliamentary Studies

Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15

Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214; cps@albaniaonline.net;

www.ascdpd.org